



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0035550/25 dt. 19.06.25
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 10 të Rregullores Nr. 03/2022 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se 1 (një) Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0035550/25, dt. 19.06.2025 të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës që menaxhohet nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm për periudhën më pak se 1 (një) Vit)

1. **Formohet** Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për marrjen në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës që menaxhohet nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm për periudhën më pak se 1 (një) Vit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Xhevdet Aruqaj – kryetar (DPU);
 - 1.2 Sebahate Tahiri – anëtare (DPU);
 - 1.3 Idriz Beqiri – anëtar (DGJKP);
 - 1.4 Minire Sungur – anëtare (rezervë - ZKKK).
2. Komisioni i formuar siaps pikës 1 (një) të këtij Vendimi, është i obliguar të shqyrtojë dhe të bëjë vlerësimin e të gjitha kërkesave që i drejtohen Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se 1 (një) Vit, e që këto prona/objekte menaxhohen nga kjo drejtori dhe janë në kompetencë të saj.
3. Komisioni obligohet që pas shqyrtimit të kërkesave, duke u bazuar në kriteret e parapara në Rregulloren Nr. 03/2022 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se 1 (një) Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës të hartoj Raport me Shkrim dhe të përgatisë Rekomandimin për Kryetarin e Komunës për lidhje të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Komisioni i lartcekur bazë për punën e tij do të ketë Rregulloren Nr. 03/2022 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se 1 (një) Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Mandati i Komisionit zgjat 2 (dy) Vite, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm Nr. 01-020/04-0035550/25, dt. 19.06.2025

I'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit